



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.302/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të qendrës së votimit 100 m, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr.302/2017 e datës 12.06.2017, me të cilin është pretenduar se kandidatet për deputet Muferah Sinik dhe Fikrim Damka, nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), ka vazhduar me vendosjen e posterave në afërsi të qendrës së votimit, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

#### A r s y e t i m

Parashtuesi i ankesës, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatet për deputet Muferah Sinik dhe Fikrim Damka, nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), ka vazhduar vendosja e posterave në afërsi të qendrës së votimit me nr.2005, në shkollën e mesme të gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, në afërsi prej 20-30 m, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është shkolla e mesëm “Gjon Buzuku” dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të votuar si Qendër e Votimit 2005 a, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.302 /2017 më datën 13.06.2017



**Kyesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*